

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE

ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “SOLEIL ON SEA” sh.p.k

Në Tiranë më datë 12.04.2025,

KREU I PJESA E PËRGJITHSHME

Ky Statut (njekohsisht dhe Akti themelimi), Ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) si dhe dispozita të tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi, rregullojnë marrëdhëniet e shoqërisë tregtare “SOLEIL ON SEA”.

Ortaku i Shoqërisë do të jetë : Shoqëria “SOLEIL & SEA” shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi L21926005F, me seli në Tiranë, Farkë, Selitë, Njësia Administrative Farkë, Rruga Rrapo Hekali, Pallati 21/2, Kati i I, Ap.3”, me ortak z. Ardit Bajraktari dhe z. Endri Mingollari, përfaqësuar nga Administratori z. Ardit Bajraktari, atësia Behar, shtetas shqiptar lindur në Poliçan më 01.09.1990 dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I00901005M

KREU II EMRI, FORMA, ZYRA QËNDRORE, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSIA E ORTAKUT

NENI 1 EMRI

Shoqëria tregtare mban emrin **“SOLEIL ON SEA”**.

Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

NENI 2 FORMA

Shoqëria tregtare **“SOLEIL ON SEA”** ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Më poshtë, në të gjitha rastet ku do të jetë shkruar Shoqëria, duhet të lexohet Shoqëria **“SOLEIL ON SEA” sh.p.k**.



NENI 3 ZYRA QËNDRORE

“SOLEIL ON SEA” SH.P.K e ka seline e saj ne Selia e shoqerise do te jete Rr. Murat Toptani , prane Kinema MIILENIUM Hyrja nr 1 ,Nr pasurie 1/434 zona kadastrale 8150 volumi 41 , faqe 111

NENI 4 OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë **“SOLEIL ON SEA” sh.p.k** është:
Sipërmarrje turistike në fushën e turizmit dhe hotelerisë nëpërmjet investimit, administrimit dhe operimit të strukturave hoteliere, fshatrave turistikë, njësive të akomodimit të turistëve, bareve, restoranteve, si dhe tu ofrojë turistëve dhe vizitorëve transport, guidë dhe aktivitete argëtuese të llojeve të ndryshme duke përfshirë edhe ato me mjete motorike, lundruese, anije apo varka, etj.
Shoqëria do të zhvillojë edhe çdo veprimtari tjetër plotësuese që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur por gjithmonë dhe në çdo rast jo si veprimtari parësore por ekskluzivisht plotësuese dhe në funksion të vënies në jetë të objektit të shoqërisë dhe në çdo rast në përputhje me legjislacionin në fuqi përse i përket kësaj fushe.
Shoqëria krijohet gjithashtu në kuadër të VKM nr.652 datë 10.11.2017 (neni 11/1) që lidhet me parashikime ligjore për shërbimin e akomodimit dhe strukturat akomoduese.

NENI 5 KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë tregtare **“SOLEIL ON SEA” sh.p.k** do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6 DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT

Shoqëria tregtare **“SOLEIL ON SEA” sh.p.k** mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7 PËRGJEGJËSIA E ORTAKUT

Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë **“SOLEIL ON SEA” sh.p.k** dhe mbulon personalisht humbjet e saj deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

KREU III KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT, KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT



NENI 8
KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KUOTAT

Kapitali themeltar i Shoqërisë “**SOLEIL ON SEA**” sh.p.k., është 100.000 lekë (njëqind mijë). Ortaku i vetëm “**SOLEIL & SEA**” shpk, është zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë 100.000 lekë, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga kontributet e Ortakëve në natyrë ose në para, të kapitalizuara në të gjitha aktivet afatgjata dhe qarkulluese të nevojshme për veprimtarinë e Shoqërisë.

a) Kapitali i regjistruar i shoqërisë, mund të zmadhohet pa kufizim, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

b) Kapitali i regjistruar i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapiatli i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

NENI 10
KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

KREU IV
ORGANET E SHOQËRISË

NENI 11
ORTAKU I VETËM

Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i vetëm.

NENI 12
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT TË VETËM

Ortaku i vetëm merr vendime për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme :

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikqyrjen e zbatimit të tyre
- b) ndryshimet në Statut
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- d) emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të audituesve të jashtëm ligjorë
- e) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit dhe audituesit e jashtëm ligjorë



- f) miratimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të ecursisë së veprimtarisë
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- h) pjestimin e kuotës
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- j) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- k) çështje të tjera të parasikuara nga ligji apo nga statuti

NENI 13 MBLEDHJA E ORTAKUT TË VETËM

Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm), do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht parashikimet sipas Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

NENI 14 ADMINISTRATORI

Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët emërohen dhe/apo shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakui Vetëm). Afati i emërimit është deri në pesë vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori ka të drejta dhe detyra :

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortaku i vetëm
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë
- d) përgatit raportin e ecursisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore, të cilat së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqiten Ortakut të vetëm për miratim
- e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur, për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për Qendrën Komëtare të Biznesit
- g) raporton në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë
- h) përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë
- i) kryen detyra të përcaktuara në ligj apo të urdhëruara me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë

Shoqëria do të administrohet nga Administratori i Vetëm i cili do të jetë z. Ardit Bajraktari me të gjitha pushtetet që i njej ligji dhe ky Statut, për një afat pese vjeçar.

Administratori mund të autorizojë me shkrim dhe të delegojë me prokurë kryerjen e një ose disa veprimimeve nga përfaqësuesi i tij, në kufijtë e tagrave që u janë dhënë nga akti i emërimit dhe njëkohësisht ju njihen nga ligji apo statuti.

KREU V

VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

NENI 15

VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE VJETORE

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti dhe i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme së bashku me raportin e ecuresë së aktivitetit dhe raportin e audituesit ligjor, brenda datës 30 Qershor të vitit pasardhës.

NENI 16

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Ortaku i vetëm ka të drejtë të marrë fitimet neto të Shoqërisë që rezultojnë nga bilanci, pasi të zbriten shumat që u përkasin detyrimeve ligjore, fondit rezervë dhe të tjera të përcaktuara me ligj ose në Statut.

Shoqëria mund ti shpërndajë fitime Ortakut të vetëm, vetëm nëse konkludohet që edhe pas pagimit të dividendëve ;

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim

KREU VI

RIORGANIZIMI, PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 17

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera, ose nëpërmjet zhndërrimit të formës ligjore. Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të vetëm.

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria priset në rastet e parashikuara me ligj ose me vendim të Ortakut të vetëm. Në rast prishje Shoqëria do ti nënshtrohet procedurës së likuidimit.

Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.



NENI 19

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që mbulon rregullime të kërkuara.

Ky Statut hartohet dhe firmoset në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Soleil&Sea sh.p.k

Administratori Ardit Bajraktari

Ardit Bajraktari 